

V E N D I M
Nr. 115, datë 31.3.2002

**PËR PROKURIMIN E DREJTPËRDREJTË TË FONDEVE PËR SIGURIMIN E
DETYRUESHËM TË MJETEVE MOTORIKE TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE PËR
PËRGJEGJËSITË NDAJ PALËVE TË TRETA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 17 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik", ndryshuar me ligjin nr.8767, datë 5.4.2001, me propozimin e Ministrisë të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Lejimin e institucioneve buxhetore, që, për fondet limit, të miratuara në Buxhetin e Shtetit të vitit 2002, të përdorin procedurën "Prokurim i drejtpërdrejtë" me Institutin e Sigurimeve sh.a. (INSIG) për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve të tyre motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta.
2. Primi që INSIG sh.a.-ja do të arkëtojë nga institucionet buxhetore të jetë vlera e primit të pastër, duke i shtuar vlerën e shpenzimeve minimale administrative, të përcaktuara me urdhër të Ministrisë të Financave.
3. Ngarkohen institucionet buxhetore për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko